



Shoqëri e Kontrollit Ligjor të Llogarive dhe Ekspertizave Kontabël

RAPORT AUDITIMI

Për Pasqyrat Financiare Konsoliduara te shoqërisë

ALDOSCH - FARMA SHPK SHPK

për periudhën nga

1 Janar deri 31 Dhjetor 2016

*Shoqëri e Kontrollit Ligjor të Llogarive dhe Ekspertizave Kontabël*

OPINIONI I AUDITUESIT TE PAVARUR**Drejtuar: Asamblesë Ortakëve****ALDOSCH - FARMA SHPK SH.P.K*****Raport mbi Pasqyrat Financiare*****Opinion**

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare te konsoliduar bashkangjitur te shoqërisë **ALDOSCH - FARMA SHPK SH.P.K** te cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar te datës 31 Dhjetor 2016 dhe pasqyrën e te ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve ne kapital dhe pasqyrën e flukseve te parasë për vitin e përfunduar ne këtë date dhe një përmbledhje te politikave te rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare japin një pamje te vërtetë dhe te besueshme te pozicionit financiar te Shoqërisë **ALDOSCH - FARMA SHPK SH.P.K** me date 31 Dhjetor 2016, si dhe te performances financiare dhe pasqyrës se flukseve te parasë per ushtrimin e mbyllur ne atë date, ne pajtim me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit (SKK).

Baza për opinion

Ne e kemi kryer auditimin tone ne përputhje me Standardet Ndërkombëtare te Auditimit (SNA). Përgjegjësia jone sipas këtyre standardeve është përshkruar ne paragrafin Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare te shprehur ne këtë raport. Ne jemi te pavarur nga kompania qe auditojme ne përputhje me Kodin e Etikes për Kontabilistet Profesioniste, se bashku me kërkesat etike relevante te auditimit te pasqyrave financiare ne Shqipëri, dhe ne kemi plotësuar edhe përgjegjësitë e tjera etike ne përputhje këto kërkesa dhe me Kodin e Etikes për Kontabilistet Profesioniste si me sipër.

Ne besojmë se evidenca e auditimit qe ne kemi marre është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për te dhënë opinionin tone te auditimit.

Çështjet Kryesore te Auditimit

Çështjet Kryesore te Auditimit janë ato çështje qe, nen gjykimin tone profesional, ishin me te rëndësishmet gjate auditimit te pasqyrave financiare te periudhës aktuale. Këto çështje janë adresuar ne kontekstin e auditimit te pasqyrave financiare ne tërësi, dhe gjate formimit te opinionit tone, për rrjedhoje, dhe ne nuk paraqesim një opinion te veçantë për këto çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe te Atyre te ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejte te këtyre pasqyrave financiare ne përputhje me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit (SKK) dhe për ato kontrole te brendshme qe drejtimi i gjykon te nevojshme për te bere te mundur përgatitjen e pasqyrave financiare qe nuk përmbajnë anomali materiale qofte për shkak te mashtrimi apo gabimi.

Ne përgatitjen e Pasqyrave Financiare, Drejtimi është përgjegjës për matjen e aftësisë se vijueshmërisë se Kompanisë, duke paraqitur nëse është rasti, çështje te lidhura me vijueshmërinë dhe te përdorë parimin e vijueshmërisë vetëm ne qofte se ne te kundërt, Drejtimi ka për qellim te likuidoje kompaninë ose te ndërpresë veprimtarinë, ose nuk ka alternative realiste për te vazhduar.

ALDOSCH FARMA SH.P.K.

Te ngarkuarit me Qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësia e Audituesit

Objektivat tone janë për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale qofte për shkak të mashtrimi apo gabimi, dhe lëshimi i raportit të auditimit që përmban opinionin tone. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është garanci që një auditim i kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit do të zbulojë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalit mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale në qofte se, individualisht ose në total, pritet që ato mund të kenë ndikim në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra duke u bazuar në këto pasqyra financiare.

Raport për kërkesat e tjera Ligjore dhe Rregullatorë

Në angazhimin tone për auditimin e Pasqyrave Financiare të **ALDOSCH - FARMA SHPK SH.P.K** nuk ka kërkesa të tjera nga ana e Drejtimit për tu raportuar nga ne.

Partneri angazhimit në auditim që rezulton në këtë raport auditori të pavarur është

Berti Pashko

HOLLY & ENDIA AUDITING sh.p.k.,



Tirane, me 30 Mars 2017

Adresa: Bll. At Gjergj Fishta, Pall. E-88, Nr. 12, K.P. 1001, tel./fax. 2270905, e-mail: hollyendiauditing@gmail.com, K31323006D, Tirane

Aldosch-Farma sh.p.k
Pasqyrat Financiare të Konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E KONSOLIDUAR E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	6- 21

Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 Dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare			15,059,340
Llogari të arkëtueshme tregtare	4	9,727,135	219,934,621
Të tjera llogari të arkëtueshme	5	185,969,109	159,945,326
Inventarë	6	174,825,835	278,957,927
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7	240,286,214	659,504,850
Total aktive afatshkurtra	8	727,859,805	1,333,402,063
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	180,278,610	316,034,291
Aktive afatgjata jomateriale	10	10,080,382	6,001,882
Huadhënie afatgjatë	11	289,845,400	321,600,000
Total aktive afatgjata		480,204,392	643,636,173
Total aktive		1,818,872,491	1,977,038,236
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	12	228,677,604	230,232,165
Llogari të pagueshme tregtare	13	15,707,543	66,002,807
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	14	103,191,185	232,472,802
Detyrime tatimore	15	1,835,880	7,060,840
Të tjera detyrime	16	171,535	1,073,720
Total detyrime afatshkurtra		349,583,746	536,842,333
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	17	702,764,949	782,393,589
Total detyrime afatgjata		702,764,949	782,393,589
Totali i detyrimeve		1,052,348,695	1,319,235,922
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Rezerva ligjore		440,120	440,120
Rezerva përkthimi		(3,228,584)	(1,235,216)
Fitime të mbartura		658,497,410	505,424,443
Fitimi i ushtrimit		110,714,849	153,072,968
Total kapitali	18	766,523,795	657,802,315
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,818,872,491	1,977,038,237

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e Konsoliduar e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	1,542,828,104	2,137,754,735
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	20	97,557,407	17,944,729
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(1,232,197,244)	(1,899,284,878)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	21	(1,186,525,187)	(1,751,879,734)
2) Të tjera shpenzime	22	(45,672,057)	(147,405,144)
Shpenzime të personelit	23	(46,326,323)	(43,152,785)
1) Paga dhe shpërblime		(43,402,366)	(40,186,315)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(2,923,957)	(2,966,470)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	24	(8,471,105)	(17,473,403)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(15,500,345)	(803,495)
Të ardhura të tjera	26	9,101	76,620,329
1) Të ardhura/shpenzime të tjera financiare		9,101	76,620,329
2) Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata		-	-
3) Interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme		-	-
Shpenzime financiare	27	(196,277,204)	(75,013,660)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(64,443,296)	(75,013,660)
2) Shpenzime të tjera financiare		(131,833,909)	-
Fitimi/humbja para tatimit		141,622,390	196,591,572
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	28	(30,907,541)	(43,518,604)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(30,907,541)	(43,518,604)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		110,714,849	153,072,968
Fitimi/humbja për:			
Interesat jo-kontrolluese		-	-
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse nga perktimi		(3,228,584)	(1,262,917)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		(3,228,584)	(1,262,917)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		107,486,266	151,810,051

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Aldosch-Farma sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në Kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Kapitali aksionar	Rezerva për kthimi	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura /humbje të akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtimit	Totali
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2014	100,000	27,701	440,120	484,624,285	131,123,020	616,315,126
Transferim në fitime të mbartura						
Te ardhura të tjera gjithpërfshirëse				20,800,158	(20,800,158)	
Fitimi i vitit		(1,262,917)				(1,262,917)
Dividendë të paguar					153,072,968	153,072,968
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2015	100,000	(1,235,216)	440,120	505,424,443	153,072,968	657,802,315
Pozicioni financiar me 1 janar 2016	100,000	(1,235,216)	440,120	505,424,443	153,072,968	657,802,315
Transferim në fitime të mbartura						
Te ardhura të tjera gjithpërfshirëse						
Fitimi i vitit		(1,993,369)				(1,993,369)
Dividendë të paguar					110,714,849	110,714,849
Pozicioni financiar me 31 dhjetor 2016	100,000	(3,228,585)	440,120	505,424,443	263,787,817	766,523,796

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Aldosch Farma sh.p.k. më 28.02.2017 dhe janë firmosur si më poshtë:

Forena Grebavaj

Hartues e pasqyrave financiare



Pasqyra e konsoliduar e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Flukset e parash nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit			
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		110,714,849	153,072,968
Shpenzimet financiare jomonetare			
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi			
Zhvierësimi i aktiveve afatgjata materiale		8,471,105	17,473,403
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:			
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale			
Ndrryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
Rritje/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		19,085,002	(262,012,273)
Rritje/(rritje) në inventarë		38,671,713	16,473,319
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		(185,704,026)	(82,077,954)
Rritje/(rënie) në parapagime dhe shpenzime të shtyra		(68,354,955)	192,898,341
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(77,116,311)	35,827,805
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve			
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		123,206,076	(6,416,273)
Pagesa për huadhenie		31,754,600	-
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera			
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera			
Dividendë të arkëtuara			
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		154,960,676	(6,416,273)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Arkëtime nga shtimi kapitalit			
Hua të arkëtuara			
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë			
Riblerje e aksioneve të veta			
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral			
Pagesa e huave			
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		(81,183,201)	(61,104,755)
Interes i paguar			
Dividendë të paguar		-	(99,290,576)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		(81,183,201)	(160,395,331)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		(3,338,837)	(130,983,799)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		15,059,340	147,306,056
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		(1,993,368)	(1,262,917)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 30 nëntor 2016	4	9,727,135	15,059,340

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Aldosch Farma" sh.p.k është themeluar më 3 mars 2003 dhe është regjistruar më 5 shkurt 2003 në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.28995

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është tregtimi me shumice dhe pakice, importi dhe eksporti i produkteve farmaceutike.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 lekë i cili zotërohet nga ortakët Aqif Hoxha .
Administrator i Shoqërisë është Z. Aqif Hoxha.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT K31503045V. Selia qendrore e saj ndodhet në Rrugën "Myslym Keta" në ambjentet e Shoqërisë Antibiotik sh.a, Tiranë.

Më 27 shtator 2010 është hapur në Kosovë kompania ProMed sh.p.k me kapital 5,000 Euro e zotëruar 100% nga "Aldosch-Farma" sh.p.k.

ProMed sh.p.k ka numër regjistrimi 70698242 dhe numër fiskal 600597671.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

2.7. Bazat e Konsolidimit

Filialet janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikën financiare dhe operative, që në përgjithësi u atribuohen aksionereve që zoterojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur është bërë vlerësimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjetër ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht që nga data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Metoda e kostos është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur në vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna, instrumentave të kapitalit neto të emetuara dhe detyrimeve të pësura ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte të blerjes. Aktivet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës. Tejkallimi i kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës të grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë. Transaksionet midis shoqerive të grupit, balancat dhe fitimet e përealizuara për transaksione ndërmjet shoqerive të grupit janë eliminuar. Gjithashtu janë eliminuar humbjet e përealizuara. Politikat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur ka qene e nevojshme për t'u përputhur me politikën e miratuar nga Grupi.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
EUR/Lek	135.23	138.28
USD/ Lek	128.17	125.79

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flusit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Hua të marra dhe të dhëna

Huat e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huat e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale***i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka qira operative dhe qira financiare.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%). Tatimi mbi fitimin në Republikën e Kosovës është 10%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.11. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Mjete monetare në bankë	6,085,105	8727494
Llogari rrjedhëse	6,085,105	8,727,494
Depozita me afat	-	-
Mjete monetare në arkë	3,585,630	6,275,446
Likuiditete në udhëtim	56,400	56,400
	<u>9,727,135</u>	<u>15,059,340</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Klientë	185,969,109	219,934,621
	<u>185,969,109</u>	<u>219,934,621</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Paradhënie për punonjësit	10,155	372,900
TVSH e arkëtueshme	497,247	941,514
Tatimi mbi fitimin	15,824,486	-
Te tjera kërkesa për arketim	991,038	1,142,603
Të arkëtueshme nga ortakut	157,502,909	157,488,309
	<u>174,825,835</u>	<u>159,945,326</u>

7. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mallra	240,286,214	278,957,927
	<u>240,286,214</u>	<u>278,957,927</u>

8. Parapagimet dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra për qera paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Parapagime për inventarë	727,589,345	658,416,992
Shpenzime të shtyra	270,460	1,087,858
	<u>727,859,805</u>	<u>659,504,850</u>

Aldosch-Farma sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lekë)

9. Aktive afatgjata materiale

<i>Kosto</i>	Toka	Ndërtesa	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	167,537,402	140,529,150	3,210,902	5,480,778	28,491,785	20,072	346,270,089
Shtesa		849,763		554,348			1,404,111
Pakësime							
Gjendja më 31 dhjetor 2015	167,537,402	140,529,150	4,060,665	6,035,126	28,491,785	20,072	346,674,200
Shtesa viti 2016			133,000	491,426	608,535		1,232,961
Pakësime		140,529,150					140,529,150
Gjendja më 31 dhjetor 2016	167,537,402	-	4,193,665	6,526,552	29,100,320	20,072	207,378,011
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2015			1,578,899	3,255,477	13,609,135	10,710	18,454,221
Amortizimi i vitit 2015			883,700	1,317,106	2,933,130	1,872	12,162,266
Pakësime		7,026,458					
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	7,026,458	2,462,599	4,572,583	16,542,265	12,582	30,616,487
Amortizimi i vitit 2016		1,668,784	554,895	466,133	2,451,721	1,498	5,143,031
Pakësime		8,695,242					8,695,242
Gjendja më 31 dhjetor 2016	-	0	3,017,494	5,038,716	18,993,986	14,080	27,064,276
Vlera neto kontabel							
Efekt i kursit të këmbimit nga përkthimet e degës		-	9,732				9,732
Gjendja më 31 dhjetor 2015	167,537,402	133,502,692	1,588,334	1,462,543	11,949,520	7,490	316,047,981
Efekt i kursit të këmbimit nga përkthimet e degës			19,749	16,340	964		35,125
Gjendja më 31 dhjetor 2016	167,537,402	0	1,156,422	1,471,496	10,107,299	5,992	180,278,610

10. Aktive afatgjata jomateriale

Gjendja e aktiveve afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2016 dhe më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

<i>Me kosto</i>	AAJM	Total
Gjendja më 1 janar 2015	10,675,165	10,675,165
Shtesa	2,519,088	2,519,088
Pakësime		
Gjendja më 31 dhjetor 2015	13,194,253	13,194,253
Shtesa	7,444,412	7,444,412
Pakësime		
Gjendja më 31 dhjetor 2016	20,638,664	20,638,664
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2015	8,257,189	8,257,189
Shtesa		
Pakësime		
Gjendja më 31 dhjetor 2015	8,257,189	8,257,189
Amortizimi i vitit	3,328,132	3,328,132
Kthim amortizimi		
Gjendja më 31 dhjetor 2016	11,585,321	11,585,321
Efekt i kursit të këmbimit nga përkthimet e degës	1,027,039	1,027,039
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2015	4,937,063	4,937,063
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2016	10,080,382	10,080,382

11. Huadhënie afatgjatë

Huadhënie afatgjatë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Huadhënie afatgjatë	289,845,400	321,600,000
	289,845,400	321,600,000

12. Hua afatshkurtra

Gjendja e huave afatshkurtra më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Hua afatshkurtra	228,677,604	230,232,165
	228,677,604	230,232,165

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Furnitorë	15,707,543	64,644,073
Detyrime tregtare ndaj paleve të lidhura	-	1,358,734
	15,707,543	66,002,807

14. Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime

Gjendja e të ardhurave të shtyra, paraggimet e klintëve më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Te ardhura te shtyra	103,191,185	232,472,802
	<u>103,191,185</u>	<u>232,472,802</u>

15. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime tatimore	1,835,880	7,060,840
	<u>1,835,880</u>	<u>7,060,840</u>

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 për shoqërinë vijnë si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime ndaj punonjesve	171,535	564,472
Detyrime ndaj ortakëve	-	-
Te tjera detyrime	-	509,248
	<u>171,535</u>	<u>1,073,720</u>

17. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Hua afatgjata	701,886,372	780,742,101
Qera financiare	878,577	1,651,488
	<u>702,764,949</u>	<u>782,393,589</u>

18. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë Aldosch-Farma sh.p.k është 100,000 Lekë, 100 kuota ose 100% zotërohen nga Aqif Hoxha

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale (në LEK)	1,000	1,000
Kapitali i nënshkruar	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

Kapitali i shoqërisë ProMed sh.p.k është 5,000 Euro i zotëruar 100% nga Aldosch-Farma sh.p.k

Rezerva ligjore është në vlerën 440,120 Lekë, njësoj si edhe vitin e kaluar.

Rezerva nga përkthimi i kurseve të këmbimit ka vlerën (3,228,584) Lekë (2015: 1,235,216) Lekë, (2014: 27,701 Lekë)

Fitimet e mbartura më 31 dhjetor 2016 janë në vlerën 505,424,443 Lekë, (2014: 484,624,285 Lekë)

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga shitja e mallrave	1,542,828,104	2,137,754,735
	<u>1,542,828,104</u>	<u>2,137,754,735</u>

20. Të ardhura të tjera nga shfrytëzimi

Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga shitja e AQT	97,483,102	17,845,000
Të ardhura të tjera	74,305	99,729
	<u>97,557,407</u>	<u>17,944,729</u>

21. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Mallra	1,186,525,187	1,751,879,734
	<u>1,186,525,187</u>	<u>1,751,879,734</u>

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Blerje energji, avull, ujë, karburant	4,454,242	5,313,648
Shpenzime qeraje	7,502,279	7,553,730
Mirëmbajtje dhe riparime	1,663,897	1,530,556
Sigurime	1,269,101	968,142
Blerje të ndryshme, kancelari etj	1,295,716	913,760
Shërbime nga të tretë	959,117	6,288
Licensa dhe koncesione	-	139,730
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,443,477	1,991,575
Shpenzime marketingu	9,153,646	1,448,584
Shpenzime për pritje dhe perfaqesime	345,278	1,464,444
Shpenzime transpoti	3,876,581	2,991,416
Komisione bankare	2,256,530	1,556,887
Sponsorizime	520,221	343,736
Taksa të ndryshme	2,883,905	490,188
Kamatevonesa	-	1,395,725
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	8,048,067	119,296,735
	45,672,057	147,405,144

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për paga	43,402,366	40,186,315
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,923,957	2,966,470
	46,326,323	43,152,785

24. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime amortizimi dhe konsumi	8,471,105	17,473,403
	8,471,105	17,473,403

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Gjopa të ndryshme	15,500,345	803,495
	<u>15,500,345</u>	<u>803,495</u>

26. Të ardhura/shpenzime nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse

Të ardhura/shpenzime nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Te ardhura /shpenzime	9,101	76,620,329
	<u>9,101</u>	<u>76,620,329</u>

27. Shpenzime financiare

Shpenzimet dhe të ardhurat nga interesi si dhe rezultati nga kurset e këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime interesi	64,455,766	75,057,898
Humbje nga kursi këmbimit	-	(10,620)
Te ardhura nga interesi	(12,470)	(33,618)
Shpenzim për shitje AQT	131,833,909	
	<u>196,277,204</u>	<u>75,013,660</u>

Aldosch-Farma sh.p.k

Shënimet e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lekë)

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	E konsoliduar		Aldosch-Farma		ProMed sh.p.k		E konsoliduar		Aldosch-Farma		ProMed sh.p.k	
	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Fitimi para tatimit												
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)												
Gjopa dhe dëmshpërblime	141,622,390	70,977,789	70,977,789	196,591,571	70,644,601	136,778,176	196,591,571	136,778,176	70,644,601	111,924,356	59,813,395	2,318,849
Shpenzime të tjera	91,245,931	81,436,382	81,436,382	114,243,205	9,809,549	539,031	114,243,205	539,031	9,809,549	109,989,600	2,318,849	-
Shpenzime të panjohura për autovetura	15,500,345	15,334,814	15,334,814	2,857,880	165,531	-	2,857,880	-	165,531	-	-	-
Humbje nga shitja e AAGJ	10,229,512	585,493	585,493	109,989,600	9,644,018	-	109,989,600	-	9,644,018	-	-	-
Kamatëvonesa	34,833,909	34,833,909	34,833,909	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime të panjohura për interesa	30,682,166	30,682,166	30,682,166	1,395,725	-	1,395,725	1,395,725	1,395,725	-	-	-	-
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	232,868,321	152,414,171	152,414,171	310,834,776	80,454,150	248,702,532	310,834,776	248,702,532	80,454,150	62,132,244	62,132,244	53,600,170
Tatim fitimi @15% (@10%)	232,868,321	152,414,171	152,414,171	310,834,776	80,454,150	248,702,532	310,834,776	248,702,532	80,454,150	62,132,244	62,132,244	53,600,170
Fitimi pas tatimit (Fitimi neto)	30,907,541	22,862,126	22,862,126	43,518,604	8,045,415	37,305,380	43,518,604	37,305,380	8,045,415	6,213,224	6,213,224	-
	110,714,849	48,115,664	48,115,664	153,072,966	62,599,186	99,472,796	153,072,966	99,472,796	62,599,186	53,600,170	53,600,170	-

29. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2015 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

30. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.